



PRILL 2026

BULETINI



Tryezë mbi zbatimin e Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjetet e mbajtur në Mitrovicën e Veriut

Më 24 prill 2026, OJQ ACDC organizoi tryezë diskutimi në veri të qytetit të Mitrovicës, të fokusuar në zbatimin e Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjetet, në kuadër të projektit “Ndërtimi i Besimit nëpërmjet të Drejtave të Njeriut”. Diskutimi trajtoi sfidat praktike me të cilat përballen qytetarët pas hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve më 15 mars 2026.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, shoqërisë civile dhe qytetarë. Panelistët përbëheshin nga: Jetmir Haziri, Drejtor i Agjencisë së Regjistrimit Civil (Ministria e Punëve të Brendshme), Valon Krasniqi, Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (MPB), Qëndrim Bytyqi, Drejtor i Departamentit Ligjor (MPB) dhe Veton Elshani, Zëvendësdirjtor Rajonal i Policisë së Kosovës për Veriun.





Diskutimi nxori në pah hendekun ndërmjet kornizës ligjore dhe zbatimit të saj në praktikë. Pjesëmarrësit ngritën disa shqetësime kryesore, duke përfshirë:

- procedurat administrative komplekse dhe jokonsistente nëpër komuna,
- vështirësitë në regjistrimin civil për personat pa shtetësi të Kosovës,
- sfidat në marrjen e dokumenteve personale dhe rregullimin e statusit rezidencial,
- kufizimet që lidhen me automjetet me targa të huaja, duke përfshirë edhe afatin tremujor,
- mungesën e informacionit të qartë dhe pasigurinë ligjore në zbatimin e ligjeve.

Tryeza e diskutimit shërbeu si një platformë e rëndësishme për identifikimin e çështjeve kryesore dhe nisjen e hapave të mëtejshëm drejt përmirësimit të zbatimit të këtyre ligjeve në praktikë.



Përmirësimi i Qasjes në Drejtësi

Në fillim të prillit, ACDC, me mbështetjen e UNMIK-ut, nënshkroi kontrata me përkthyes dhe bashkëpunëtorë profesional që do të angazhohen në Gjykatën Themelore në Mitrovicën e Veriut. Ky bashkëpunim i vazhdueshëm synon të përmirësojë më tej qasjen në drejtësi për të gjitha komunitetet duke kapërcyer barrierat gjuhësore dhe duke forcuar kapacitetet e institucioneve gjyqësore.



Së bashku për lumenj të pastër: Punëtoritë mbi mbrojtjen e burimeve ujore

Gjatë gjithë muajit, ACDC organizoi një seri punëtorish mbi mbrojtjen e burimeve ujore dhe rëndësinë e veprimit kolektiv në ruajtjen e mjedisit.

Përmes punës në grup dhe diskutimeve, pjesëmarrësit fituan një kuptim më të mirë të sfidave kryesore, identifikuan çështjet lokale dhe propozuan zgjidhje konkrete për përmirësimin e komuniteteve të tyre. Punëtoritë u organizuan në kuadër të projektit "Së bashku për lumenj të pastër", një iniciativë e përbashkët e REC dhe ACDC. Aktivitetet u zbatuan në kuadër të programit IWRM-K, të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Qeverisë së Kosovës, me zbatim nga Skat Consulting Ltd. në konsorcium me Agjencinë Austriake të Mjedisit (EAA).



Të rinjtë në veprim për një mjedis më të pastër

Në Ditën e Tokës, më 22 prill, ACDC organizoi aksion pastrimi në veri të Mitrovicës së bashku me të rinj nga komunitete të ndryshme. Ky aktivitet kontribuoi në mbrojtjen e mjedisit dhe rriti ndërgjegjësimin për rëndësinë e përgjegjësisë kolektive për ruajtjen e mjedisit lokal.

Deklarata e përbashkët e Shoqërisë Civile

ACDC, së bashku me disa organizata të shoqërisë civile, publikoi gjithashtu një deklaratë të përbashkët në lidhje me ngjarjet në Patriarkanën e Pejës, duke shprehur shqetësim për sjelljen e papërshtatshme gjatë një vizite të organizuar studentore dhe duke u bërë thirrje institucioneve të sigurojnë mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore.



[SRB](#)



[ENG](#)



[ALB](#)

ACDC në Media

Dushan Radaković foli për Radio Kontakt Plus, rreth kërcënimeve kibernetike dhe sfidave të sigurisë dixhitale me të cilat përballen qytetarët në Kosovë.



Dushan Radaković për Insajder, mbi futjen e mbikëqyrjes me video në qendrat e votimit dhe ndikimin në procesin zgjedhor.



Dushan Radaković për Kosovo Online, mbi zhvillimet politike në Mitrovicën e Veriut dhe ndikimin e tyre në institucionet lokale.



Aleksandar Rapajiq, duke folur për Kosovo Online, komentoi mbi vendimet politike dhe implikimet e tyre për stabilitetin dhe marrëdhëniet rajonale.



www.acdc-kosovo.org



office@acdc-kosovo.org



www.facebook.com/Ngoacdc



www.instagram.com/acdc.kosovo



www.x.com/ngo_acdc

